



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA
PREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Dalës-Izlazn:

Nr. -1-20
Br.

Data 18.02.2020
Datum

OBILIQ-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 61 të Statutit të Komunës së Obiliqit, caktoj:

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa me dt.24.02.2020, (e hënë) në ora 10:00 në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Planit të punës së Kryetarit për vitin 2020
4. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së, për bartjen e mjeteve nga viti 2019-2020
5. Shqyrtimi i kërkesës së DKA-së
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

Kryesuesi i Komitetit

Burim Gërguri





Dalës-Izlasna

Nr. -1-22
Br.

Data 18.02.2020
Datum

OBILIQ-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.27.01.2020, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Burim Gërguri, Florije Jashari, Fatmir Bekteshi, Qendresa Dubova, Linda Sadiku, Hysni Mjeku dhe Slavisa Spasic

Të pranishmit tjerë: Lendita Bekteshi Memishi, drejtoreshë e ad.së përgj. Naim Miftari, drejtor i DSHPE-së, Arben Berisha, drejtor i DPUKP-së, Vlora Mjekiqi Kabashi, drejtoreshë e DSHMS-së, Ilire Kelmendi Shema, drejtoreshë e DKRS-së, Bejtullah Mjekiqi, drejtor për bujqësi dhe zhvillim rural, e Ganimete Aliu, zyrtare për barazi gjinore, përf.i OSBE-së dhe përf.i IZHL-së

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesuesi cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara
3. Shqyrtimi i kërkesës së DSHMS-së
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Kuvendit komunal për vitin 2019
5. Shqyrtimi i Planit vjetor të punës së Kuvendit komunal për vitin 2020
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u aprovua njëzërit nga të pranishmit,

1. Pika parë e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

2. Pika dytë e rendit të ditës

Aprovohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

3. Pika tretë e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga DSHMS-ja, për ndarjen dhe bartjen e parcelës, e cila figuron në emër të shkollës fillore, në emër të QKMF-së, Obiliq (AMF-së, Breznicë).

Vlora Kabashi Mjekiqi – Ne të gjithë e dimë se objekti ekzistues AMF-ja në Breznicë, nuk i plotëson nevojat për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, atëherë ne me kërkesë iu kemi drejtuar DPUKP-së, për iniciimin e procedurave, që të pajisemi me leje të ndërtimit. Paraprakisht kërkojmë nga Kuvendi komunal që në minimum 10 ari të parcelës me nr.P-72602008-01189-0, me sipërfaqe 11053,0 m² e cila figuron në emër të shkollës fillore të ndahet dhe bartet në emër të QKMF-së, Obiliq (AMF-së Breznicë).

Fatmir Bekteshi – E kam një kërkesë që objekti mundësisht të ndërtohet sa më në skaj, në mënyrë që të mos shfrytëzohet në mes dhe të na pengoj në të ardhmen sepse aty sigurisht se do të bëhet edhe një park dhe rrethoja.

Kryesuesi – Pyeti sa do të jetë në m² ambullanta e re e shfrytëzueshme.

Vlora Kabashi Mjekiqi – Përgjegjet përafërsisht 250 m².

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht i rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DSHMS-së, për bartjen e 10 ari tokë, në emër të QKMF-së nga parcela ekzistuese P-72602008-01189-0, në sipërfaqe prej 11053,0 m² pronë e shkollës fillore, prona nevojitet për ndërtimin e objektit të ri të AMF-së Breznicë.

Pika e 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti Raportin vjetor të punës së Kuvendit komunal për vitin 2019 dhe i njoftoi të pranishmit në mënyrë detale me raportin në fjalë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht i rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim Raportin vjetor të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2019.

Pika e 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti në mënyrë detale Planin vjetor të puës së Kuvendit komunal për vitin 2020.

Hysni Mjeku - Përveç vërejtjeve që kam ndaj kolegëve për mospjesëmarrjen në takimin që e kemi mbajtur, unë besoj e është një plan bukur i mirë. Nëse, e zbatojmë këtë plan ashtu qysh është paraparë atëherë ne e kemi bërë një punë të mirë që është edhe një ndihmesë e Kuvendit dhe shpresoj se ky Kuvend do të jetë edhe më i suksesshëm se në vitin e kaluar.

Kryesuesi – Ju njoftoj se gjithsesi në këtë vit do të funksionalizojmë edhe 2 Komitete joobligative, që është edhe kërkesë nga MAPL-ja, dhe këto 2 Komitete do të jenë trupa ndihmës të Kuvendit komunal.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht i rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim të Planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2020.

Pika e 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga Ali Konjusha, nga Sibofci i cili kërkon material ndërtimor për ndërtimin e kulmit të shtëpisë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht kërkesën e Ali Konjushës ia rekomanduan DSHPE-së dhe DSHMS-së, për shqyrtim.

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga Eljesa Terbunja, Kryetar i Handikos-it në Obiliq, Projekt Propozim për blerjen e shërbimeve për vitin 2020.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht kërkesën e Eljesa Terbunjës ia rekomanduan DSHMS-së për shqyrtim.

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga Fatmir Muliqi, nga Obiliqi për meremetimin e shtëpisë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht kërkesën e Fatmir Muliqit ia rekomanduan DSHMS-së dhe DSHPE-së për shqyrtim.

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga Mentor Avdyli, kompania “Dalma” me seli në Llazarevë, për dhënjen e parcelave në pronësi të Komunës.

Arben Berisha – Ne e kemi pasë një kërkesë nga Mentor Avdyli, dhe ia kemi refuzue lejen ndërtimore sepse ai e ka një parcelë në shfrytëzim, por ai ka ndërtue në parcelë tjetër dhe kërkon leje ndërtimore për atë parcelë. Pra, rruga të cilën ai e ka ndjekë nuk është në formën ligjore.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht kërkesën e Mentor Avdylit – DALMA, e refuzuan me arsyetim se kërkohet formë tjetër dhe procedurë.

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga Rrukolli sh.p.k nga Skenderaji për shëndrrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore, ZK, Milloshevë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht kërkesën e N.N Rrukolli, sh.p.k ia rekomanduan DPUKP-së, për trajtim.

Fatmir Bektashi - Është e vërtetë, se kjo kërkesë ka ardhë disa herë, por pse e specifikon Ministrinë dhe unë propozoj që të formohet një Komision për këto raste.

Kryesuesi – Sqaron se Drejtoria e bujqësisë i ka dhënë përgjegje dhe ne pa një sqarim nga DPUKP-ja, kërkesën s’mund ta shqyrtojmë.

Pika e 7 e rendit të ditës

Fatmir Bekteshi – Unë e kam një kërkesë nga banorët e fshatit Sibofc, për gurëthyesin i cili ka filluar të ndërtohet në fshatin Sibofc, kush e ka dhënë pëlqimin. Kërkoj raport për punën e gurëthyesit kush e ka dhënë pëlqimin dhe pse e ka dhënë.

Kryesuesi – Sqaron se çështja e gurëthyesit është çështje e Ministrisë së Minjerave dhe Mineraleve, dhe sa jam i informuar Drejtorja e inspeksionit e ka ndaluar.

Mbledhja përfundoi në ora 11:3'

Procesmbajtëse



Azize Zeneli

